



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 16- 40669 / 15
Kaçanik, 30.11. 2015

Në bazë të dispozitave të nenit 11 , 12.2 (c) , 17 (s) si dhe 40.2 (a) të Ligjit Nr.03 /L-040 -Për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), të nenit 34. 5 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 30.11.2015, mori këtë :

VENDIM

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR MBROJTJEN E TË MITURVE NGA DUKURITË QË DËMTOJNË SHËNDETIN DHE ZHVILLIMIN E TYRE

1. Me këtë vendim, apovohet Rregullorja **01Nr. 16-40669/15** me tekstin e mëtejme: Rregullore për mbrojtjen e të miturve nga dukuritë që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre.
2. Me këtë rregullore përcaktohen, kushtet për ndalimin e dukurive që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e të miturve. Kushtet në të cilat personat fizik, organizatat tregtare dhe shërbyese, mund t'u ofrojnë në shitje ose shërbime tjera që janë të ndaluara me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, e që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e të miturve.
3. Rregullorja është hartuar nga Komisioni i formuar me Vendim të Kryetarit të Komunës, është përmbledhur në gjithsej 9 nene, dhe e njëjta është pjesë përbërse e këtij Vendimi.

Me Rregulloren njoftohen:

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, permes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante- zbatues të rregullores, dhe
3. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi